



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “PESHKIM”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Peshkim**”, me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Peshkim”, Niveli II i KSHK-së, (klasa e 10-të dhe e 11-të).
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Peshkim”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Peshkim**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë

hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “Peshkim“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Arti detar dhe lundrim	76	31
2	Hidrometeorologji	64	26
3	Teknikë peshkimi	60	24
4	Lundrim detar në anijen e peshkimit	46	19
	TOTALI	246	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) “Arti detar dhe lundrim”, kl. 10 dhe kl. 11; **(76 orë)**
- Kategorizimi i anijeve dhe në veçanti i atyre të peshkimit 2 orë
 - Vetitë lundruese të anijes 3 orë
 - Ndërtimi dhe materialet që përdoren për ndërtimin e anijes 12 orë
 - Sistemi i lëvizjes dhe drejtimit të anijes 8 orë
 - Cimat, kavot dhe takilazhi në anije 12 orë
 - Vinçat në anije 6 orë
 - Jeta në anije 7 orë

- Emergjencat në anije 8 orë
- Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri në anije 4 orë
- Pajisjet e mbrojtjes nga uji në anije 4 orë
- Rimorkimi i anijeve 2 orë
- Qëndrimi i anijes në spirancë, bovë dhe bankinë 4 orë
- Sinjalet për parandalimin e përplasjeve në det 4 orë

b) **“Hidrometeorologji”, kl. 11: (64 orë)**

- Objekti dhe detyrat e Hidrometeorologjisë 2 orë
- Atmosfera 3 orë
- Temperatura e ajrit 9 orë
- Avulli i ujit në atmosferë orë
- Kondensimi i avujve të ujit 9 orë
- Shtypja atmosferike 7 orë
- Qarkullimi i atmosferës 9 orë
- Rrymat dhe relievi i fundit të detit 5 orë
- Masat ajrore dhe frontet atmosferike 9 orë
- Parashikimi i motit 4 orë

c) **“Teknikë peshkimi” Kl. 10 dhe Kl.11: (60 orë)**

- Teknika e peshkimit në ujërat detare dhe të ëmbla 3 orë
- Materialet e fijëzuara të veglave të peshkimit 7 orë
- Litarët. Përdorimi i tyre në veglat e peshkimit 6 orë
- Pluskuesit. Përdorimi i tyre në veglat e peshkimit 6 orë
- Peshat. Përdorimi i tyre në veglat e peshkimit 6 orë
- Rrjetat dhe pëlhurat. Përdorimi i tyre në veglat e peshkimit 8 orë
- Teknologjia e riparimit dhe përforcimit të rrjetave 16 orë
- Jetëgjatësia e materialeve dhe veglave të peshkimit 4 orë
- Teknika e peshkimit me varg grepash peshkimi 4 orë

d) **“Lundrimi detar në anijen e peshkimit”, kl.13 (46 orë)**

- Organizimi i punës, shërbimit dhe pushimit në bord FAO & ILO 4 orë
- Kodi Ndërkombëtar i sinjaleve të IMO-s 8 orë
- REPAD (Rregullorja e Parandalimit të Përplasjeve në Det) 8 orë
- IALA (Shoq. Ndërkombëtare e Ndhmuesve Detar për Lundrimin dhe Autoritetet e Fenerëve Detar) 6 orë
- Ndërtimi, stabiliteti dhe kontrolli i tij në raste dëmsh 10 orë
- Komunikimi detar, legjislacioni dhe institucionet 8 orë
- Metodatat e kërkimit të peshkut në det 2 orë